



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4033 Prot.

Roskovec, më 02.06 2021

VENDIM

NR 35 .DATË 31 .05 .2021

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË GIZ ALBANIA PËR NDËRTIMIN E QENDRËS SË
KOMPOSTIMIT DHE RICIKLIMIT TË MBETJEVE ORGANIKE, NË PASURINË NR.
206/21/A, ZK 2599, NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC”**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 shkronja “a” dhe shkronja “c”, si dhe nenit 54 shkronja “e/1” të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Memorandumit të Bashkëpunimit “Për modernizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në territorin e Bashkisë” nr. 3929 prot, datë 06.08.2020 dhe Memorandumit të Bashkëpunimit “Për ndërtimin dhe operimin e qendrës së kompostimit dhe burimore për territorin e bashkisë”nr.3885 datë 27.05.2021, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e kërkesës së GIZ ALBANIA për ndërtimin e Qendrës së Kompostimit dhe Riciklimit të Mbetjeve Organike, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit “Për modernizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në territorin e Bashkisë” nr. 3929 prot, datë 06.08.2020 dhe Memorandumit të Bashkëpunimit “Për ndërtimin dhe operimin e qendrës së kompostimit dhe burimore për territorin e bashkisë”nr.3885 datë 27.05.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe GIZ Albania.
2. Qendra e kompostimit dhe riciklimit të mbetjeve organike do të ndërtohet në pasurinë nr. 206/21/A, zona Kadastrale 2599, Fshati Marinëz, Njësia Administrative Kuman, në pronësi të Bashkisë Roskovec, me sipërfaqe 2500 m2.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

